

Durres me 09.08.2018

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“BISCOTTI DEL PASTORE ALBANIA” SH.P.K

HYRJE

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “BISCOTTI DEL PASTORE ALBANIA” sh.p.k themelohet ne perputhje me ligjin nr 9901 date 14.04.2008 “per tregetaret dhe shoqerite tregetare” I ndryshuar dhe ligjin nr 9723 date 03.05.2007 per qendren kombetare te regjistrimit sot me Date Nente Gusht Dy mije e Tetembedhjete.

KREU 1


Themelimi , Emri , Objekti , Kohezgjatja , Selia dhe Adresa e Faqes se Internetit

Neni 1 : Data e Themelimit , Emri dhe Themeluesit , Administratori

- 1.1** Sot ditën e enjte , me date 09.08.2018 (Nente Gusht Dy mije e tetembedhjete) Une themeluesi FRANCESCO MARTUCCI krijoi nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.
- 1.2** Emri I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte “BISCOTTI DEL PASTORE ALBANIA” sh.p.k
- 1.3** Administratori I shoqerise per pese vjet nga data e regjistrimit eshte FRANCESCO MARTUCCI

Neni 2 : Objekti

- Pasticeri, prodhim e tregetim me shumice dhe pakice te embelsirave dhe brumrave, import-export te artikujve te ndryshme ushqimore, prodhim ambalazhim , prodhime te ndryshme ushqimore , te pastave ushqimore, te fresketa e te tharta, te mbushura ose jo. Produkte me shumice e pakicete produkteve te furre's dhe makaronave ne pergjithesi, sherbime restoranti me furnizimin e publikut me ushqime dhe pije si per llogari te vet dhe per llogari te te treteve. Tregeti import-eksport artikuj te ndryshem industrial dhe te tjere, transport per vete dhe te trete.
- Supermarket, market



- Import –Export tregeti artikuj te ndryshem ushqimore ,metrazheve,konfeksione te te gjitha llojeve, mallrave te akcizes dhe nenprodukteve te tyre,industrial dhe materaleve te lendeve te ndertimit etj.,veprimtari ndertimore
- Prodhime te ndryshme ne fushen e industrise, bujqesise dhe tregetimi me shumice dhe pakice I tyre Brenda dhe jashte vendit.
- Prodhim veshje e veshembathje (konfeksione me material porosities) kepuce e komponente te tyre dhe tregetimi I tyre brenda e jashte vendit.
- Import – Export artikuj te ndryshem , material te prere , lende e pare per veprimtarine fason.
- Import – Export I materialeve te gatshme te perpunuara , te gjitha llojet e copave , pelhurave ,fije ,sendeve, makinerive,mallrave, nen/degezimet e te gjitha kategorive te permendura me lart, aksesoreve per perpunimin e lendes se pare dhe cdo artikull qe eshte ne interest e shoqerise dhe e lejueshme nga forma e shoqerise.
- Te funksionoje, operoje dhe te kryeje cdo veprimtari ne fushen e : veprimtarise fason (deri ne operacionet perfundimtare ,qepje,hekurosje,paketim) me material porositesi dhe jo vetem ,si dhe per treg te brendshem.
- Perpunim, paketim e trajtim I kulturave bujqesore, farerave te ndryshme dhe kimikate per bujqesine.
- Import –Export I paisjeve per sherbime te pergjithshme, materiale elektroshtepiake, materiale elektrike , hidraulike , hidrosanitare, te gjitha llojet e materialeve te ndertimit dhe nendegzimeve te tyre ; makineri elektrike dhe mekanike; orendi ;fabricate PVC; metale dhe nenelemente te tij, I te mirave te pergjithshme qe kerkohen ne treg dhe qe shoqeria mendon ti komercializoje, te cdo malli –produkti – sendi qe lejohet nga forma juridike e shoqerise.
- Tregetimi me shumice dhe pakice I makineri-paisje te perdorshme ne sherbime te pergjithshme; material elektroshtepiake; material te ndertimit te te gjitha kategorive dhe nendegzime te tyre, mallrave dhe sendeve qe kerkohen ne treg dhe ku shoqeria parapelqen te investoje dhe ushtroje veprimtari tregtare.
- Te mare me qera , ne perdorim ,huaperdorje ,apo ne tituj te tjere mjete detare me qira Brenda dhe jashte vendit dhe ti perdore ato sipas qellimeve te shoqerise.
- Te fitoje tituj pronesia mbi pasuri te paluajtshme e te luajtshme , te tjetersoje , te jape me qera dhe te kontaktoje ne cdo forme ligjore mbi te drejtat dhe titujt e pronesise se ketyre pasurive e sendeve.Te jete pale kotraktuese per mareveshjet civile e tregtare, klering, shitjen apo blerjen per interest e shoqerise te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme , te cdo sendi , titulli apo te drejte te komercializohet.
- Agjensi spedicionere , Agjensi detare, transporti mallrash dhe udhetaresh, ne transport tokesor ,detar dhe ajro, Agjensi turistike dhe shit blerje biletash ,Agjensi komisionere, Agjensi punesimi, Ushtrim I transportit per llogari te vet apo te te treteve.

- Ushtrim I cdo veprimtarie te ligjshme, te luajtshme per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 te ligjit tregtar nr 9901 dt 14.04.08)

Si ne cdo aktivitet tjeter sherbimi e financimi qei sherben rritjes , zhvillimit te fuqizimit te shoqerise.

Neni 3 : Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat .

Neni 4 : Selia dhe adresa elektronike

Selia e shoqerise "BISCOTTI DEL PASTORE ALBANIA" SH.P.K eshte Dures, L.Nr.11, Rr.P.Meksi , Apartament me Nr.Pasurie 1/871/nd+3-47 , Zone Kadastrale 8514, Vol.41 , Fq.46 .

Adresa elektronike per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon :
biscottidelpastore@gmail.com

KREU 2

Neni 5: Vlerat dhe pagesat e kapitalit te rregjistruar


5.1. Kapitali themeltar fillestar I shoqerise "BISCOTTI DEL PASTORE ALBANIA" sh.p.k eshte 100.000 leke (njeqind mije).Kapitali I shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga ortaku ne shoqeri ku zoteron nje kuote te vetme dhe ndahet si me poshte: FRANCESCO MARTUCCI zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

5.2.Kontributet ne para do te paguhen plotesisht menjehere. Kontributet ne natyre do ti kalojne shoqerise menjehere pas rregjistrimit ne QKR.

5.3. Pagesat e kontributeve ne para do te kryhen ne banke dhe ne cdo agjensi tjeter te specializuar per ne dhe te njohur ne ligj.

Neni 6 : Kerkesa per te paguar kuotat dhe terheqja e kuotave te papaguara

6.1.Administratori mund ti kerkoje ortakeve te shoqerise pjesen e kontributeve te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre dhe ne cdo ortak (pas marrjes se njoftimit prej 14 ditesh te plota ne te cilen percaktohet koha dhe vendi I kryerjes se pageses) , I paguan shoqerise Shumen e kerkuar per kuotat e zoteruara. Njoftimi per pagese mund te parashikoje shlyerjen me keste te



kontributeve te papaguara. Personi te cilit I drejtohet njoftimi per pagesen e kontributit do te jete pergjegjes per njoftimet qe I drejtohen atij pavarsisht kalimit te mepasshem te pronesis se kuotave.

6.2. Zoteruesit e perbashket te nje kuote do te jene pergjegjes bashkarisht dhe ne menyre solidare per shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit te mesiperm.

6.3. Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar , personi pergjegjes per shlyerjen e kontributeve do te paguaje nje interes mbi Shumen e papaguar me nje kamatvonesë 4 % ne vit duke filluar nga data e parashikuar per pagesen.

6.4. Ne rast se pas njoftimit per shlyerjen e kontributeve , pagesa perkatese nuk kryhet brenda afatit te parashikuar , Administratori mund te njoftoje parapakisht te pakten katermbedhete dite te plota personin pergjegjes per shlyerjen e kontributeve , duke I kerkuar pagesen e shumes se pashlyer se bashku me shumet e mundeshme shtese te kamatvoneses. Njoftimi duhet te permbaje vendin ku do te kryhet pagesa dhe deklarimin ne rast moszbatimi te tij. Kuotat te cileve u referohet njoftimi do te anulohen.

6.5. Nese pagesa nuk kryhet brenda afatit te njoftimit , kuota me te cilen lidhet njoftimi , mund te anulohet me vendim te administratoreve dhe anulimi do te perfshije te gjithë dividendet ose shumet e pagueshme ne lidhje me kuotat e anuluar te papaguara deri ne momentin e anulimit.

6.6. Ne pajtim me dispozitat ligjore, kuotat e anuluar mund te shiten , rishperndahen ortakeve ose te kalohen sipas afateve dhe menyrave qe administratoret konsiderojne te pershtatshme.

6.7. Ne pajtim me dispozitat ligjore , kuota e anuluar humbet cilesine e ortakut ne lidhje me kete kuote por do te jete pergjegjes ndaj shoqerise per te gjitha kontributet qe do te shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqerise ne daten e anulimit te kuotes se bashku me kamatvonesen e llogaritur per keto kontribute perpara anulimit te kuotes.

Neni 7 : Llojet e kuotave , Te drejtave dhe kufizimeve

7.1. Ne perputhje me dispozitat e ligjit dhe pa cenuar te drejtat qe rrjedhin nga kuotat ekzistuese , kuotat mund te emerohen me te drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblese se Pergjithshme ,te marre me shumicen e kualifikuar (tre te katertat) te votave te ortakeve, ne perputhje me parashikimet e nenit 87 te ligjit.

Neni 8 : Certifikatat e kuotave



8.1. Secili ortak ka te drejte te perfitoje nje certificate per kuoten e zoteruar prej tij . Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certificate per kuotat e zoteruara bashkarisht nga disa persona dhe dorezimi I certificates ndaj perfaqesuesit te zoteruesve te perbashket te kuotave , ne perputhje me piken 2 te nenit 72 te ligjit . Emrat e zoteruesve te perbashket te kuotave do te renditen ne certifikaten e kuotes . Certifikata do te gezoje cilesine e letres me vlere.

Neni 9 : Kalimi me kontrate I kuotave

9.1. Kontrata e kalimit te kuotes behet me shkrim dhe sipas formalitetve te percaktuara nga administratoret. Kjo kontrate do te dergohet ne seline e shoqerise.

9.2. Administratori mund te refuzoje rregjistrimin e kalimit te kuotes ne QKR ne rast se nje kuote nuk eshte shlyer ploteseisht ose ne rast se Administratoret nuk jane dakort me personin te cilit I kalon kuota.

9.3. Nese Administratori refuzon te rregjistroje kalimin e kuotes , ai do te njoftoje per mospranimin personit te cilit I kalohen kuotat. Brenda nje muaji nga data ne te cilen eshte paraqitur ne shoqeri kerkesa per rregjistrimin e kalimit te kuotes.


Neni 10 : Kalimi I kuotave me trashegimi ose si pasoje e falimentit

10.1. Nese nje ortak vdes , trashegimtari ose trashegimtarete ne rastin e bashkezoterimit te kuotave , dhe trashegimtarete e tij ne rast se ky person ishte zoterues ose trashegimtar I vetem I bashkezoteruesve te kuotave , do te personat e vetem te njohur nga shoqeria si gezues se te drejtave mbi kuoten e tij, pavarsisht parashikimeve te ketij satuti, pasuria e ortakut te vdekur nuk clirohet nga pergjegjesia ne lidhje me kuoten e zoteruar nga ai vetem apo se bashku me personat e tjere.

10.2. Personi qe fiton te drejten mbi nje kuote si pasoje e vdekjes apo falimentimit te nje ortaku pas paraqitjes se provave te kerkuara nga Administratoret , mund te zgjedhe te behet zoterues I kuotes ose te kerkoje rregjistrimin e kuotes ne emer te nje personi tjeter te caktuar prej tij si perfitues I kuotes. Nese personi I mesiperme zgjedh te behet zoterues I kuotes ai kalon kuoten ne dobi te nje personi tjeter.

10.3. Personi qe fiton te drejta mbi nje kuote si pasoje e vdekjes apo falimentit te nje ortaku do te kete te drejta qe gezonte zoteruesi I kuotes duke perjashtuar te drejten e pjesemarrjes ose te votes ne cdo mbledhje te Asamblese se Pergjithshme deri ne momentin e rregjistrimit ne QKR.

Neni 11 : Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit themeltar



11.1. Asambleja e pergjithshme , me shumice te kualifikuar , mund te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise duke rritur kuotat e ortakeve ekzistues ne shumicen e percaktuar ne vendimin perkates. Zmadhimi i kapitalit me qellim pranimin e e ortakeve te rinj ne shoqeri miratohet nga Asambleja e Pergjithshme me shumicen e kualifikuar te votave te ortakeve.

11.2. Shoqeria mund te vendos zvogelimin e kapitalit themeltare te shoqerise me vendimin e Asamblese se Pergjithshme , te marre shumicen e kualifikuar te votave.

Neni 12 : Blerja e kuotave te veta

12.1. Shoqeria mund te bleje kuotat e veta dhe te kryeje pagesen per blerjen e tyre , jo nga fitimet e shoqerise qe do tu shperndahen ortakeve apo emerimi i kuotave te reja vetem nese shoqeria permbush kushtet per shperndarjen e fitimeve sipas nenit 77 te ligjit dhe Administratoret leshojne nje certificate te aftesise paguese te parashikuara nga ky nen.

12.2. Ne rast se blerja e kuotave nuk eshte ne perputhje me kushtet e nenit 77 te ligjit ,padite mbi pergjegjesine e shoqerise mund te ngrihen ne pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 te ligjit.

KREU 3

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME


Neni 13 : Thirja e asamblese se pergjithshme

13.1. Administratori therrret asamblene e pergjithshme me kerkesen e ortakeve sipas nenit 84 te ligjit , do te procedojme me thirrjen e asamblese se pergjithshme .

13.2. Mbledhja e asamblese se pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me poste ose poste elektronike (email) drejtuar cdo ortaku , perفشire edhe perfaqesuesin e kuotave ne zoterim te perbashket. Njoftimi duhet te kryhet te pakten ne 7 dite te plota para dates se caktuar per mbledhjen pervec rasteve kur njoftimi i mbledhjes se asamblese se pergjithshme i cili eshte miratuar nga shumica e ortakeve te cilet zoterojne jo me pak se 100 % te vleres nominale te kuotave .Secilit ortak se bashku me njoftimin per mbledhje i dergohet dhe numri PIN per te mundesuar pjesmarrjen dhe votimin elektronik ne mbledhje.

13.3. Mbledhjet e asamblese se pergjithshme jave te vlefshme ne rast moskryerje te paqellimshme te njoftimit apo te mos marrjes te njoftimit te mbledhjes nga persona te cilet kane te drejte te marrin kete njofim, ne perjashtim te rastit kur shoqeria provon se personi i ka dhene shoqerise nje adrese te pasakte.

Neni 14 : Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme



14.1. Asambleja e pergjithshme merrvendime te vlefshme vetem me arritjen e kuorunit te parashikuar nga neni 86 I ligjit .Ortaket ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese nepermjet mjeteve elektronike perfshire teleperformancen(conference call), audio ose audio – video ne perputhje me nenin 88 te ligjit.Ortaket qe marrin pjese me mjete komunikimi elektronik kane te drejte te votojne nepermjet numerit PIN qe u eshte derguar se bashku me njoftimin per mbledhjen e asamblese se pergjithshme

14.2 Administratori cakton kryetarin e mbledhjes si dhe nje person per te mbajtur process – verbalin e saj.

14.3. Nese administratoret nuk deshiron te caktohet si kryetar I mbledhjes ose nese asnje prej administratoreve nuk eshte I pranishem per pesembledhjet minuta duke filluar na ora e caktuar per fillimin e mbledhjes , ortaket e pranishem dhe me te drejte vote zgjedhin njerin prej tyre si kryetar te mbledhjes.

14.4.Administratori pavaresisht se nuk eshte ortak ka te drejten e pjesemarrjes si dhe te marre fjalen ne cdo mbledhje te asamblese se pergjithshme

14.5.Kryetari me pelqimin e asamblese se pergjithshme te mbledhur ne perputhje me kuorumin e caktuar me ligj mund (dhe eshte I detyruar nese kerkohet nga asambleja e pergjithshme) te shtyje mbledhjen e asamblese se pergjithshme por ne mbledhjen e dyte mund te diskutohen vetem ato ceshtje te cilat do te ishin diskutuar rregullisht nese nuk do te ishte shtyre mbledhja e mepareshme.Kur mbledhja e asamblese se pergjithshme shtyhet te pakten katermbledhjet dite njoftimi do te kryhet te pakten shtate dite te plota perpara kesaj date dhe ne te do te percaktohet vendi dhe ora e mbledhjes se shtyre dhe pershkrimi I pergjithshem I rendit te dites.Ne rast te kundert dhenia e njoftimit nuk eshte e nevojshme.

14.6. Asambleja vendos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit nuk kerkohet ne menyren e duhur nje njoftim I fshehte.Votimi I fshehte mund te kerkohet nga : a – Kryetari ose b – Nje ortak ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5 % te kapitalit themeltar te shoqerise .Kerkesa e bere nga nje perfaqesues I autorizuar I ortakut ka te njejten vlere me kerkesen e paraqitur nga vete ortaku .

14.7.Me perjashtim te kundershtimit te nje ortaku , deklarimi I kryetarit se vendimi eshte marre ne menyre unanime ose me nje shumice te caktuar nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe rregjistrimi perkates ne proces verbalin e mbledhjes perben prove perfundimtare te ketij fakti , pa pasur nevojte per numerimin e votave te rregjistruara pro apo kunder votimit.

14.8.Ne rast se ka kundershtime per kete deklarate do te zhvillohet nje votim I fshehte ne lidhje me percaktimin e numerit te votave pro dhe kunder vendimit.



Neni 15 : Votat e ortakeve

15.1. Ne perputhje me te drejta ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat ose cdo kuote I jep ortakut (ne rastin kur eshte individ) te pranishem apo perfaqesuesit e tij te autorizuar ose ortakut (ne rastin kur eshte person juridik) I cili eshte I pranishem permes perfaqesuesit ligjor apo perfaqesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt , te drejten e nje vote.

15.2. Asnje ortak nuk do te votoje ne mbledhjen e e asamblese se pergjithshme , personalisht ose nepermjet perfaqesuesit ne lidhje me kuoten e zoteruar prej tij , nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me kete kuote.

15.3. Cdo kundërshtim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet kryetarit , vendimi I te cilit do jete perfundimtar. Te gjitha votat e pakundërshtura ne nje mbledhje ose ne mbledhje te shtyre do te jene te vlefshme.

Neni 16 :Vendimi me prokure

16.1. Perfaqesuesi do te emerohet nga ortaku sipas forms se meposhtme ose ne formen qe mund te miratohet nga administratoret :

“sh.p.k” Une / Ne / Te nenshkruarit ,....., ne cilesine e ortakut / ortakeve te shoqerise se lartpermendur emeraj / me, ose ne pamundesi te tij, ne cilesine e perfaqesuesit /ve tim/ tone per te votuar ne emer/emrat tim/tone dhe ne llogarine time/tone ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme se shoqerise e cila do te mbahet20....., dhe ne cdo mbledhje te shtyre . Nenshkruar me20.....

16.2. Ne rastet kur deshirohet tju jepet ortakeve mundesi per te udhezuar perfaqesuesin per menyren e veprimit , caktimi I perfaqesuesit behet sipas forms se meposhtme (ose ne formen e zakonshme apo formen qe mund te miratohet nga administratoret) ... “ sh.p.k” Une / Ne / i/te nenshkruarit te, ne cilesine e ortakut / ortakeve te shoqerise se lartpermendur , emeraj /me, ose ne pamundesi te tij, ne cilesine e perfaqesuesit /ve tim/tone per te votuar ne emer /emrat tim/tone dhe ne llogarine time /tone ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme e shoqerise e cila do te mbahet me20..... dhe ne cdo mbledhje te shtyre. Kjo forme do te perdoret per vendimet e permendura me poshte. Pervec udhezimeve te tjera, perfaqesuesi mund te votoje ose abstenoje sic e quan te arsyeshme. Nenshkruar me ...20...

16.3. Caktimi me shkrim I perfaqesuesit ose ne nje kopje te noterizuar apo e miratuar nga administratoret depozitohet ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter Brenda territorit te Republikes se Shqiperise sic percaktohet ne njoftimin per mbledhjen e asamblese se pergjithshme ose ne ftesen per te caktuar nje perfaqesuese te derguar nga shoqeria ne lidhje me mbledhjen e asamblese se pergjithshme .Akti I emerimit te perfaqesuesit duhet te



depozitohet jo me vone se dyzet e tete ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre , ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi.

16.4. Ne rast se akti I emerimit te perfaqesuesit jepet nepermjet komunikimit elektronik te deguar ne adresen elektronike sipas percaktimeve te pikes 3 te nenit 4 , te ketij statuti, ky akt duhet te merret jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre ne te cilen duhet te votoje perfaqesuesi .

Neni 17: Hetimet e posacme

17.1. Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 91 te ligjit te paraqesin nje kerkese te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate noteriale ne seline e shoqerise e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.

KREU 4

ADMINISTRATORET

NENI 18 : Emerimi I Administratoreve

18.1. Asambleja e pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise per nje periudhe 5-vjecare, ne pajtim me parashikimet e shkronjes "c" te pikes 1 te nenit 81 dhe nenit 95 te ligjit . Emerimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga asambleja e pergjithshme I cili nese miratohet sjell emerimin e personit te propozuar si administrator.

18.2. Kufizimet ne lidhje me emerimet e administratoreve parashikohet ne piken 2 te nenit 95 te ligjit.

18.3. Personi I meposhtem caktohet si administrator I pare I shoqerise deri ne emerimin e tij nga mbledhja e pare e asamblese se pergjithshme eshte Z. FRANCESCO MARTUCCI.

18.4. Administratori Z. FRANCESCO MARTUCCI do te caktohet si kryetar I mbledhjeve te administratoreve deri ne zgjedhjen nga mbledhja e pare e zakonshme.

Neni 19 : Kompetencat e administratorit



19.1.Politikat tregtare te shoqerise do te administrohen nga administratoret te cilet mund te ushtrojne te gjitha kompetencat qe nuk I rezervohen asamblese se pergjithshme sipas nenit 81 te ligjit.Ndryshimet e statusit nga asambleja e pergjithshme dhe udhezimet e asamblese se pergjithshme nuk do te shfuqizojne aktet e mepareshme te administratoreve, te cilat do te ishin te vlefshme nese ndryshimi nuk do te ishte kryer ose udhezimi nuk do te ishte dhene.

19.2.Administratoret mund tua delegojne kompetencat e tyre cdo komiteti I cili perbehet nga nje ose me shume administrator.Cdo delegim kompetencash mund te kryhet ne perputhje me kushtet qe vendosen adminstratoret dhe mund te revokohet ose ndryshohet.Administratoret nuk mund te delegojne detyrimet ligjore.

Neni 20 : Skualifikimi dhe shkarkimi I administratoreve

20.1.Detyra e administratorit perfundon ne rast se :

20.1.1.Personi nuk eshte me administrator sipas parashikimeve te ligjit pefshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te ligjit.

20.2.2Personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese .

20.3.3.Personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore .

20.4.4.Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine.

20.5.5.Ka munguar me shume se gjashte muaj rradhazi pa lejen e administratoreve te tjere ne mbledhjet e administratoreve te mbajtur gjate kesaj periudhe dhe asambleja e pergjithshme me propozimin e administratoreve vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 21 : Shperblimi , Perfitimet e tjera dhe shpenzimet e administratoreve

20.1.Administratoret shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga asambleja e pergjithshme ne perputhje me parashikimet e nenit 97 te ligjit.

21.2.Asambleja e pergjithshme mund te parashikojte perfitime nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime apo forma te tjera , per cdo person I cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo I punesuar ne shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj , ose per cdo familje te tyre (perfsire bashkeshortin /en , ish- bashkeshortin /en) ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre dhe mund te paguajne kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.



21.3.Adminstratoreve mund tu paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit ,akomodimit dhe shpenzime te tjera te lidhje me pjesmarrjen e tyre ne mbledhjen e administratoreve ose te asamblese se pergjithshme ne lidhje me permbushjen e detyrave te tyre.

Neni 22 : Mbledhjet e administratoreve

22.1.Mbledhjet e administratoreve do te mbahen sipas nevojave te aktivitetit tregtar te shoqerise.

22.2.Vendimet e mbledhjes se administratoreve merren ne kuorumin e votave qe mund te percaktohen nga administratoret dhe ne rast se ky kuorum nuk eshte percaktuar si do jete ky.

22.3.Asambleja e pergjithshme cakton njerin prej adminstratoreve me detyren e kryetarit te mbledhjes se adminstratoreve I cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Kryetari do te caktoje cdo mbledhje te administratoreve ne te cilat ai eshte I pranishem.Ne rast se kryetari nuk deshiron te drejtoje mbledhjen apo nuk eshte I pranishem Brenda 5 minutave nga ora e caktuar per mbledhjen administratoret e pranishem mund te emerojne njerin prej tyre si kryetar te mbledhjes.

22.4.Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesmarresve .Ne rast numeri te barabarte votash , vota e kryetarit do jete vendimtarja.

22.5.Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e administratoreve , ose nga ndonje komitet I administratoreve apo nga persona te cilet veprojne ne cilesine si administrator,pavaresisht nese behet e ditur me vone nese ka pasur ne emerimin e nje administratori ose te njerit prej tyre ka qene I skualifikuar nga nga mbledhja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin do te konsiderohen te vlefshme njesoj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si administrator dhe te kishin te drejten te votonin ne mbledhje.

22.6.Vendimi me shkrim I nenshkruar nga te gjithe administratoret qe kane te drejte te njoftohen per mbledhjet e administratoreve ose nga komiteti I adminstratoreve do te konsiderohet si I vlefshem dhe I efektshem njelloj si te ishin miratuar ne mbledhjen e administratoreve , e mbledhur dhe zhvilluar rregullisht.

Neni 23 : Kufizimet ne votimet e administratoreve

23.1.Administratoret nuk do te lidhin mareveshje ose do te votojne ne mbledhjen e administratoreve per ceshtje ne te cilen keta anetare kane direkt ose indirekt nje interes apo detyrim material I cili mund te jete ne kundershtrim me interes e shoqerise , ne pajtim me



nenin 13 te ligjit , deri ne momentin kur ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme te gjithë anetaret kane rene dakort qe :

1.Te autorizojne lidhjen e kesaj mareveshje

2.Te autorizojne kete anetar qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje.Autorizimi mund te jete I pergjithshem ose I posacem per nje ceshtje te caktuar .Autorizimi I pergjithshem duhet te rregjistrohet prane QKR.

23.2.Vota e administratorit nuk do te llogaritet ne kuorumin e pjesemarresve ne mbledhjen ne lidhje me vendimin per te cilen ky anetar nuk ka te drejte vote .Dispozitat e nenit 89 te ligjit do te zbatohen ne perjshtim te administratorit nga vendimet e marra ne ket mbledhje.

23.3.Ne rast se ne mbledhjen e administratoreve ose komitetit te administratoreve diskutohet nje ceshtje lidhur me te drejten e votes se administratorit , ceshtja mund ti drejtohet kryetarit te mbledhjes perpara perfundimit te mbledhjes , vendimi I tij I lidhur me cdo administrator te ndryshem nga ai vete do jete perfundimtare dhe I forms se prere.

Neni 24 : Proces verbalet e mbledhjes se administratoreve

24.1.Administratoret kujdesen qe ne libra te posacem te mbahen proces verbalet e :

A –te gjitha takimet e kryera nga administratoret.

B – te gjitha mbledhjeve te administratoreve te posacem , mbledhjeve te administratoreve dhe komiteteve te administratoreve perfshire dhe emrat e administratoreve te pranishem ne kete mbledhje.


KREU 5

DIVIDENTET DHE KALIMI I FITIMEVE NE KAPITALIN THEMELTAR

Neni 25 : Dividentet

25.1.Pas plotesimit te parashikimeve te nenit te ligjit shoqeria me shumice te kualifikuar te votave te asamblese se pergjithshme mund te deklaroje shperndarjen e dividenteve ne perputhje me te prejtat perkatese te ortakeve.

25.2.Ne perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe lidhen me kuotat te gjithë dividentet deklarohen dhe paguhen ne perputhje me Shumat e paguara per kuotat per te cilat paguhet dividenti.Te gjithë dividentet pjestohen dhe paguhen ne perpjestim te drejte me shumat e paguara per kuotat, pjese ose pjeseve te periudhes per te cilen paguhet dividenti, ne



rast se kuota emetohet me kushtin e perfitimit te dividendit nga nje date e caktuar dividenti do te paguhet ne perputhje me kete kusht.

25.3.Asnje dividend ose pagese ne para qe lidhet me nje kuote nuk do te mbarte interesa ndaj shoqerise nese nuk parashikohet nga te drejtat qe lidhen me kuoten.

25.4.Cdo dividend qe nuk eshte kerkuar te paguhet Brenda 12 vjeteve nga data e maturimit , ne rast se vendoset ne shumice te kualifikuar votash nga asambleja e pergjithshme do te perfitohet nga shoqeria e cila nuk do te jete e detyruar ta paguaje ate.

KREU 6

DISPOZITA E FUNDIT

Persa nuk eshte permendur ne kete statut zbatohet dispozita e ligjit 9901 , date 14.04.2008 "Per tregetarët dhe shoqerite tregtare" dhe dispozitat e K.Civil.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

FRANCESCO MARTUCCI



Durres me 09.08.2018

AKT THEMELIMI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR


"BISCOTTI DEL PASTORE ALBANIA" SH.P.K

Sot ditën e Enjte me datë 09.08.2018 (Nente Gusht Dy mijë e tthembedhjetë) Une FRANCESCO MARTUCCI, i biri i MATEO lindur dhe banues në Itali CASTROVILLARI, e datëlindjes 30.10.1979, vendosa të krijoj me kapitalin tim personal një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar. Kjo shoqëri është një shoqëri me 1 ortak: -FRANCESCO MARTUCCI zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 leke që përben 100% të kapitalit themelues të shoqërisë. Administrator i shoqërisë për një afat 5 vjeçar nga kjo datë është Z. FRANCESCO MARTUCCI lindur me 30.10.1979. Shoqëria do të mbajë emrin "BISCOTTI DEL PASTORE ALBANIA" sh.p.k. Kapitali themelues i kësaj shoqërie do të përbehet nga një kapital 100.000 leke (njëqind mijë) i cili është paguar dhe depozituar nga ortakët e shoqërisë. Selia e shoqërisë "BISCOTTI DEL PASTORE ALBANIA" SH.P.K është Durres, L.Nr.11, Rr.P.Meksi, Apartament me Nr.Pasurie 1/871/nd+3-47, Zone Kadastrale 8514, Vol.41, Fq.46.

Adresa elektronike për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
biscottidelpastore@gmail.com

Objekti i shoqërisë "BISCOTTI DEL PASTORE ALBANIA" sh.p.k është:

- Pasticeri, prodhim e tregëtim me shumicë dhe pakicë të embelsirave dhe brumrave, import-export të artikujve të ndryshme ushqimore, prodhim ambalazhim, prodhime të ndryshme ushqimore, të pastave ushqimore, të fresketa e të tharta, të mbushura ose jo. Produkte me shumicë e pakicë të produkteve të furrës dhe makaronave në përgjithësi, shërbime restoranti me furnizimin e publikut me ushqime dhe pije si për llogarë të vetë dhe për llogarë të tjerë. Tregëti import-eksport artikuj të ndryshëm industrial dhe të tjerë, transport për vetë dhe të tjerë.
- Supermarket, market
- Import –Export tregëti artikuj të ndryshëm ushqimore, metrazheve, konfeksione të të gjitha llojeve, mallrave të akcizës dhe nënprodukteve të tyre, industrial dhe materialeve të lendeve të ndërtimit etj., veprimtari ndërtimorë
- Prodhim të ndryshëm në fushën e industrisë, bujqësisë dhe tregëtimit me shumicë dhe pakicë të tyre Brenda dhe jashtë vendit.



- Prodhim veshje e veshembathje (konfeksione me material porosities) kepuce e komponente te tyre dhe tregetimi I tyre brenda e jashte vendit.
- Import – Export artikuj te ndryshem , material te prere , lende e pare per veprimtarine fason.
- Import – Export I materialeve te gatshme te perpunuara , te gjitha llojet e copave , pelhurave ,fije ,sendeve, makinerive,mallrave, nen/degezimet e te gjitha kategorive te permendura me lart, aksesoreve per perpunimin e lendes se pare dhe cdo artikull qe eshte ne interest e shoqerise dhe e lejueshme nga forma e shoqerise.
- Te funksionoje, operoje dhe te kryeje cdo veprimtari ne fushen e : veprimtarise fason (deri ne operacionet perfundimtare ,qepje,hekurosje,paketim) me material porositesi dhe jo vetem ,si dhe per treg te brendshem.
- Perpunim, paketim e trajtim I kulturave bujqesore, farerave te ndryshme dhe kimikate per bujqesine.
- Import –Export I paisjeve per sherbime te pergjithshme, materiale elektroshtepiake, materiale elektrike , hidraulike , hidrosanitare, te gjitha llojet e materialeve te ndertimit dhe nendegzimeve te tyre ; makineri elektrike dhe mekanike; orendi ;fabricate PVC; metale dhe nenelemente te tij, I te mirave te pergjithshme qe kerkohen ne treg dhe qe shoqeria mendon ti komercializojte, te cdo malli –produkti – sendi qe lejohet nga forma juridike e shoqerise.
- Tregetimi me shumice dhe pakice I makineri-paisje te perdorshme ne sherbime te pergjithshme; material elektroshtepiake; material te ndertimit te te gjitha kategorive dhe nendegzime te tyre, mallrave dhe sendeve qe kerkohen ne treg dhe ku shoqeria parapelqen te investoje dhe ushtroje veprimtari tregtare.
- Te mare me qera , ne perdorim ,huaperdorje ,apo ne tituj te tjere mjete detare me qira Brenda dhe jashte vendit dhe ti perdore ato sipas qellimeve te shoqerise.
- Te fitoje tituj pronesie mbi pasuri te paluajtshme e te luajtshme , te tjetersoje , te jape me qera dhe te kontaktoje ne cdo forme ligjore mbi te drejtat dhe titujt e pronesise se ketyre pasurive e sendeve.Te jete pale kontraktuese per mareveshjet civile e tregtare, klering, shitjen apo blerjen per interest e shoqerise te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme , te cdo sendi , titulli apo te drejte te komercializohet.
- Agjensi spedicionere , Agjensi detare, transporti mallrash dhe udhetaresh, ne transport tokesor ,detar dhe ajro, Agjensi turistike dhe shit blerje biletash ,Agjensi komisionere, Agjensi punesimi, Ushtrim I transportit per llogari te vet apo te te treteve.
- Ushtrim I cdo veprimtarie te ligjshme, te luajtshme per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 te ligjit tregtar nr 9901 dt 14.04.08)

Si ne cdo aktivitet tjeter sherbimi e financimi qei sherben rritjes , zhvillimit te fuqizimit te shoqerise.

Ne fillim te aktivitetit te shoqerise si administrator I saj do te jete Z.Francesco Martucci e ditelindjes 30.10.1979 per nje periudhe 5 vjecare me te drejte perseritjeje .Me vone dhe kurdohere me miratimin e asamblese se ortakeve do te vendoset per administrator te ri te shoqerise .Administratori si dhe ortaku i shoqerise do te mbajne pergjegjesi ligjore per te gjitha demet qe mund te shkaktohen nga veprimtaria e kesaj shoqerie .Kohezgatja e shoqerise do te jete pa afat.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

FRANCESCO MARTUCCI

